

## KONCEPTDOKUMENTI PËR KRYEPROKUROR

Emri:	Shpëtim
Mbiemri:	Peci

Bazuar në kompetencat ligjore të parapara për pozitën që aplikoni, ju lutem të ofroni si vijon:

### I. Analizën tuaj:

1. Si e vlerësoni gjendjen aktuale në Prokurorinë e Shtetit?
  2. Si e vlerësoni gjendjen aktuale në prokurorinë për të cilën keni aplikuar?
  3. Cilat janë mangësitë dhe sfidat kryesore të kësaj prokurorie?
  4. A mendoni se strategjitë aktuale të sistemit adresojnë nevojat e prokurorisë për të cilën aplikoni si Kryeprokuror?
1. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, Këshilli Prokurorial dhe në përgjithësi Prokuroria e Shtetit, kohëve të fundit ka ndërmarrë një sërë veprimesh të rëndësishme me qëllim të forcimit të sistemit të drejtësisë dhe me qëllim të ngritjes së transparencës dhe llogaridhënies. Njëra ndër pikat kyçe është edhe emërimi i prokurorëve të rinj me datë 31.10.2024 në të cilin Këshilli Prokurorial i Kosovës i ka propozuar Presidentes së Republikës së Kosovës për dekretim listën përfundimtare me prokurorë të rinjë, me qëllim të ngritjes së efikasitetit në trajtimin e rasteve penale, që në mënyrë indirekte do të ndikojë edhe në punën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë sepse në të njëjtën Prokurori janë propozuar tre (3) prokurorë, e që do ta rrisë edhe efikasitetin brenda kësaj Prokurorie në trajtimin e rasteve penale, duke e ditur se që nga largimi i prokurorëve të nacionalitetit serb, gjendja në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë është rënduar, andaj propozimi i prokurorëve të rinjë është më se i mirëseardhur, gjithashtu Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit përmes transferimit të përkohshëm kohë pas kohe ka transferuar prokurorë nga Prokuroritë tjera në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë me qëllim të trajtimit më të shpejtë të rasteve.

Gjithashtu me qëllim të rritjes së transparencës dhe komunikimit, Sistemi Prokurorial ka lançuar një portal të ri duke krijuar njëmbëdhjetë faqe interneti për secilën prokurori përfshirë edhe ZKPSH-në që synon rritjen e transparencës dhe dhënien e informacioneve të plota për qytetarët. Gjithashtu Prokuroria e Shtetit rregullisht publikon raportet 24 orëshe për punën e saj, duke informuar publikun për numrin e aktakuzave të ngritura dhe numrin e personave të ndaluar. Një sërë dokumentesh të sistemit prokurorial dhe Prokurorit të Shtetit në përgjithësi janë edhe Plani Strategjik i Sistemit



Prokurorial 2022-2024, Plani i Verpimit për Zbatimin e Planit Strategjik, Strategjia për Sundim të Ligjit, dokumente këto që synojnë rritjen e efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënies.

Krijimi i Zyrës për Rikthimin e Aseteve në kuadër të ZKPSH-së që ka për qëllim gjurmimin dhe identifikimin e asteve përfshirë ato jashtë vendit, duke bashkëpunuar me institucione financiare dhe agjenci tjera relevante, si dhe duke kryer bashkëpunim juridik ndërkombëtar me qëllim rikuperimin e asetëve të fshehura jashtë Kosovës ka qenë një nevojë e kahmotshme me qëllim koordinimi për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Këto të lartcekura tregojnë për vazhden e përpjekjeve që Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës synojnë që në kuadër të kompetencave të tyre të ndërmarrin veprime konkrete me qëllim ta avancimit dhe ruajtjes së pavarësisë së sistemit prokurorial, e që ruajtja e pavarësisë, ngritja e transparencës dhe llogaridhënies i bëjnë këto institucione më kredibile dhe më të forta.

Në këtë kuptim, ashtu siç e ka të përcaktuar rolin e saj në kuadër të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Prokuroria e Shtetit duhet që të synojë që t'a ruajë pavarësinë dhe paanshmërinë, duke mos lejuar ndikimet nga jashtë, e po ashtu edhe të ngrisë transparencën dhe llogaridhënien përmes dokumenteve strategjike, e po ashtu edhe përmes udhëzimeve të detyrueshme me qëllim unifikimi të praktikave në kuadër të Sistemit Prokurorial.

2. Gjendja e përgjithshme në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë aktualisht nuk është e mirë, kjo për shkak të largimit tash e sa kohë të prokurorëve të nacionalitetit serb, gjë që ka bërë që numri i rasteve që trajtohen në kuadër të kësaj Prokurorie të jetë i madh në mungesë të prokurorëve, pasi që siç u theksua të gjithë prokurorët e nacionalitetit serb janë larguar, e të cilët kanë pjesë e kësaj Prokurorie në përputhje me Marrëveshjen për Drejtësinë mes Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ka bërë përpjekje të vazhdueshme që përmes transferimit të përkohshëm të prokurorëve t'a zbusë gjendjen në këtë Prokurori duke sjellë kohë pas kohe prokurorë nga Prokuroritë tjera me qëllim që t'i dalin në ndihmë Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, e cila për momentin përbëhet nga dhjetë (10) prokurorë duke e përfshirë Kryeprokurorin, e dihet mirëfilli që kjo Prokurori ka kompetencë territoriale dhe lëndore të veprimit për shtatë (7) komuna, që e bënë Prokurorinë Themelore në Mitrovicë në aspektin territorial dhe lëndor të dytën në aspektin e hapësirës gjeografike pas Prokurorisë Themelore në Prishtinë. Andaj, rritja e numrit të prokurorëve është nevojë e menjëhershme sepse krahasuar me



numrin derisa kanë qenë edhe prokurorët e nacionalitetit serb kemi qenë gjithsej 15 prokurorë, ndërkaq tanimë jemi vetëm 10 prokurorë. Po ashtu, objekti me të cilin ndodhemi është objekt privat dhe kushtet e punës nuk janë më të mirat të mundshme, duke qenë se nuk ka hapësira të mjaftueshme, po ashtu stafi administrativ është në numër të vogël, duke rënduar kështu edhe më tepër punën e përditshme.

Një problematikë tjetër e kësaj Prokurorie është që në përputhje me legjislacionin në fuqi si rezultat i largimit të prokurorëve serb, përfaqësuesi i kësaj Prokurorie në Këshillin Prokurorial të Kosovës tash e sa kohë mungon, duke e bërë kështu më të vështirë adresimin e problemeve më për së afërmi të kësaj Prokurorie në Këshillin Prokurorial të Kosovës. Kohët e fundit, siç u theksua janë bërë hapa konkretë drejt përmirësimit të kësaj gjendjeje, ashtu që nga konkursi i fundit për rekrutimin e prokurorëve të rinjë, tre (3) prokurorë janë propozuar që funksionin e prokurorit t'a ushtrojnë në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, mirëpo dihet mirëfilli që në përputhje me legjislacionin në fuqi këta prokurorë për periudhën një (1) vjeçare nuk do të mund të ushtrojnë funksionin e tyre në mënyrë të plotë për shkak të trajnimeve në Akademinë e Drejtësisë, megjithatë ardhja e tyre do të jetë një input i rëndësishëm në trajtimin e rasteve, po ashtu së fundmi është rritur edhe numri i bashkëpunëtorëve profesionalë, gjë që ka ndikuar pozitivisht në punën e kësaj Prokurorie.

3. Në këtë kuptim, mangësitë kryesore të kësaj Prokurorie janë numri i ultë i prokurorëve dhe stafit administrativ, objekti ku ushtron veprimtarinë kjo Prokurori. Sfidë po ashtu mbetet edhe fakti se tre prokurorët e rinjë funksionin e tyre do ta ushtrojnë në kuadër të Departamentit të Përgjithshëm, duke bërë kështu që përsëri Departamenti për Krime të Rënda dhe Departamenti për të Mitur të funksionojnë me numër të limituar të prokurorëve, për momentin në kuadër të Departamentit për Krime të Rënda janë të angazhuar tre (3) prokurorë duke e përfshirë kryeprokurorin, ndërkaq në Departamentin për të Mitur është vetëm një prokuror.

Sfidë tjetër është edhe numri i madhi lëndëve, ku një prokuror në Departamentin e Përgjithshëm për afërsisht është i ngarkuar me 800 lëndë me kryerës të njohur (PP), prandaj zvogëlimi i numrit të lëndëve mbetet njëra ndër sfidat më të mëdha të kësaj Prokurorie, gjithashtu numri i gjyqtarëve në proporcion me prokurorë është më i lartë, duke bërë kështu që angazhimi në secën gjyqësore të jetë enorm duke limituar kohën për trajtimin e rasteve në zyrë.

4. Padyshim që Plani Strategjik i Sistemit Prokurorial që përfshinë fuqizimin e efikasitetit dhe efektivitetit të administrimit të sistemit prokurorial, fuqizimi i kapaciteteve insitucionale dhe profesionale, po ashtu rritja e transparencës



dhe llogaridhënies nëse do të implementoheshin në formë të përpiktë padyshim që do të sillnin edhe rezultate më të mira. Megjithatë, numri i prokurorëve në krahasim me lëndët e pranuar është shumë i vogël prandaj edhe implementi i kësaj strategjie është vështirë i realizueshëm për shkak të rrethanave të sipër cekura. Megjithatë, ardhja e prokurorëve të rinjë do të ndikojë edhe në implementimin e Strategjisë dhe Planit Strategjik 2022-2024. Mirëpo, dokumenti si i tillë po që se do të implementohej në tërësi do të adresonte në mënyrë të plotë nevojat e kësaj Prokurorie.

## II. Vizioni juaj për përmirësimin e punës operative në prokurorinë që keni aplikuar?

Ju lutem listoni/përmendni veprimet tuaja afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata:

1. Cili është vizioni juaj për të përmirësuar punën operative gjatë mandatit tuaj?
  2. Cilat janë objektivat tuaja kryesore?
  3. Cilat janë sfidat që prisni gjatë përmbushjes së këtyre objektivave?
  4. Si do t'i tejkalonit ato?
- Gjatë mandatit tim si Kryeprokuror synoj që me qëllim të përmirësimit të punës operative të realizoj këto objektiva:
- a) **Rritja e numrit të prokurorëve dhe stafit të ri mbështetës;**
- b) **Në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë, organizata ndërkombëtare si EULEX, OSBE të mbajë trajnime të specializuara në hetimin e krimit të organizuar, krimeve kundër integritetit seksual, dhunës në familje, veprave penale kundër pasurisë me qëllim të përgatitjes të prokurorëve dhe stafit mbështetës;**
- c) **Përmirësimin e teknologjisë dhe digjitalizimit** ku përfshihet programi SMIL dhe aplikacionet tjera me qëllim të hetimit më të shpejtë të veprave penale, specifikisht trajnimet për teknologji dhe mbledhjen e provave elektronike;
- d) **Fokusimin në efikasitet dhe menaxhimin e ngarkesës në punë**, kjo do të bëhet përmes aplikimit të procedurave alternative të zgjidhjes së rasteve, e që është në përputhje edhe me politikën e ZKPSH-së dhe KPK-së, aplikimi në çdo rast të mundshëm i institutit për pranimin e fajësisë, që synoj në kolegjum me prokurorët do të kërkoj nga të njëjtit që tek çdo rast konkret krahas aktit akuzues palës t'i propozohet edhe Marrëveshja për Pranimin e Fajësisë, sepse kjo pastaj do të hapte rrugë edhe për ushtrimin e mjetit juridik në raport me të gjeturat e çështjes, e po ashtu kontribut thelbësor në këtë çështje do të jipte edhe Udhëzuesi



për Politikë Ndëshkimore i Gjykatës Supreme dhe Dokumenti i miratuar nga ZKPSH lidhur me politiken ndëshkimore.

e) **Rritja e transparencës dhe e komunikimit dhe bashkëpunimi** me akterë vendorë dhe ndërkombëtarë, e kjo do të bëhet përmes ueb-faqes apo portalit të sistemit prokurorial, ku synoj që me qëllim të hapjes për publikun të publikoj aktivitetet e kësaj Prokurorie, po ashtu takimi me qytetarë, e që do të ndikojë direkt në rritjen e transparencës e po ashtu edhe do të rriste besimin e publikut në sistemin prokurorial dhe gjyqësor, gjithmonë duke u kujdesur që kjo hapje të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe ligjet pozitive. Gjithashtu, rol të rëndësishëm duke parë pozitën strategjike të Mitrovicës ka edhe bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare për shkak të specifikave të këtij regjioni, prandaj synoj që të mbaj takime të rregullta me Policinë e Kosovës, EULEX-in, KFOR-in, OSBE si dhe organizatat tjera regjionale dhe ndërkombëtare, me qëllim të adresimit të problemeve dhe sfidave që janë specifike për regjionin e Mitrovicës, duke marrë parasysh që në këtë regjion pjesë përbërëse të shoqërisë janë edhe minoritetet serbë, boshnjakë, ashkali, egjiptas etj., prandaj është e nevojshme që për shkak të specifikave të këtij regjioni t'u mundësohet adresimi edhe kësaj kategorie të shoqërisë tonë.

f) **Monitorimi dhe vlerësimi i performancës**, e kjo do të bëhet përmes vendosjes së treguesve të qartë të performancës, e që përcaktimi i këtyre treguesve të matshëm dhe specifikë do të ndikojnë në monitorimin dhe kohën e trajtimit të rasteve në përputhje edhe me udhëzimet së ZKPSH-së si dhe me dispozitën e shqyrtimit të detyrueshëm të lëndëve që do të bëhet në mënyrë periodike, e që do të ndikojë edhe në ngritjen e efikasitetit dhe efektivitetit.

g) **Përmes marrjes së mendimeve nga qytetarët dhe organizatat tjera ligjzbatuese** me qëllim të përmirësimit të procedurave dhe shërbimeve të ofruara nga kjo Prokurori.

### III. Vizioni për të menaxhuar personelin në sistemin prokurorial

Ju lutem renditni hapat konkretë që do t'i ndërmerrnit gjatë mandatit tuaj:

1. Cili është modeli juaj në menaxhimin e stafit?
2. Si planifikoni ndarjen e barabartë të punës për stafin?
3. Si planifikoni të përmirësoni llogaridhënien dhe profesionalizmin e stafit?



- Modeli që unë synoj të ndërtoj gjatë mandatit tim në menaxhimin e stafit është i përqëndruar dhe i strukturuar në performancë dhe në promovimin e bashkëpunimit dhe zhvillimit profesional. Kjo nënkupton ndërmarrjen e disa hapave konkretë që përfshijnë:
  - a) **Organizimi i strukturës së qartë dhe efektive**, kjo nënkupton se stafi duhet të jetë i ndarë në kuadër të departamenteve të kësaj Prokurorie, e që përfshinë Departamentin e Përgjithshëm, Departamentin për të Mitur dhe Departamentin për Krime të Rënda, andaj edhe stafi duhet të jetë i ndarë në kuadër të këtyre departamenteve dhe i specializuar në trajtimin e rasteve të këtyre departamenteve;
  - b) **Struktura hierarkike të jetë e qartë dhe e definuar në mënyrë të qartë**, kjo nënkupton që në radhë të parë prokurorët të kenë linjë të qartë raportimi për efikasitetin dhe përmirësimin e rrjedhës së komunikimit ndërmjet niveleve të ndryshme të stafit;
  - c) **Rekrutimi dhe zhvillimi i vazhdueshëm profesional**, që nënkupton se procesi i rekrutimit duhet të bazohet në meritë dhe transparencë, zgjedhja e stafit të kualifikuar dhe me përvojë që përputhet me kërksat e pozicionit të veçantë duke u siguruar që procesi të jetë i drejtë dhe i pavarur, sjell edhe efikasitet dhe efektivitet në punë;
  - d) **Menaxhimi i performancës dhe vlerësimi i rregullt**, kjo synoj të arrihet përmes vendosjes së treguesve të qartë për efikasitetin dhe cilësinë e punës së prokurorëve në bashkëpunim me KPK-në duke bërë vlerësime të rregullta të cikleve të vlerësimit përmes vlerësimeve gjashtë mujore dhe një vjeçare, duke dhënë udhëzime të qarta edhe për stafin tjetër, me qëllim që t'i kuptojnë fushat se ku duhet të përmirësohen.
  - e) **Promovimi i etikës dhe integritetit**, rol të rëndësishëm ka edhe etika dhe integriteti në punën e përditshme, ashtu që në bashkëpunim me KPK-në dhe mekanizmave që ka krijuar do të trajtohen shqetësimet duke u siguruar që të gjithë prokurorët dhe stafi mbështetës ndjekin standartet më të larta profesionale dhe morale.
  - f) **Vendosja e rregullave të qarta me qëllim të parandalimit të konfliktit të interesit**, duke u siguruar që vendimet e këtij institucioni bazohet në fakte dhe të dhëna të drejta.
  - g) **Mbledhjet e rregullta, mbajtja e takimeve - kolegjiuemeve javore** me qëllim diskutimi të çështjeve kryesore dhe problemeve praktike, me qëllim unifikimi të veprimeve, në mënyrë që mos të ketë dallime në veprime në mes të punës së prokurorëve e po ashtu edhe të stafit mbështetës.



#### IV. Hapat që do të ndërmerrni për përmirësimin e integritetit dhe llogaridhënies së sistemit, prokurorisë dhe besimit të publikut?

Ju lutem listoni/përmendni veprimet tuaja afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata:

1. Çfarë hapash do të ndërmerrni për të ngritur nivelin e besueshmërisë në Prokurorinë tuaj, duke vënë baraspeshë mes transparencës dhe konfidencialitetit të procedurës?
  2. Cilat janë planet tuaja për të siguruar punë cilësore në Prokurorinë tuaj?
  3. Cilat janë planet tuaja për përmirësimin e llogaridhënies së përgjithshme në Prokurorinë tuaj?
- Për të rritur besueshmërinë në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë është e nevojshme të krijohet një ekuilibër mes transparencës dhe konfidencialitetit duke e bërë të qartë se çka konsiderohet transparencë e çka konsiderohet konfidencialitet, duke siguruar kështu qytetarët që të kenë besim në veprimtarinë e Prokurorisë dhe të jenë të informuar. Mirëpo gjithmonë duke pasur parasysh që njëkohësisht të ruhet integriteti i procedurës penale, e një baraspeshë e tillë do të bëhet duke ndërmarrë hapat e mëposhtëm:
- a) **Hartimi i udhëzimeve të qarta në bashkëpunim me KPK-në dhe ZKPSH-në** dhe në përputhje me dispozitat e KPP-së, ku përcaktohet qartë se cilat informacione mund të publikohen gjatë një hetimi apo çështjeje dhe se cilat të dhëna duhet të mbesin konfidenciale. Po ashtu, publikimi i raporteve periodike me qëllim që qytetarët të informohen për numrin e trajtuar të çështjeve dhe rezultatet e arritura, pa kompromentuar të dhënat e ndjeshme ku përfshihen të miturit apo raste të ngjajshme;
  - b) **Roli i zëdhënësit të Prokurorisë** është kryesor në informimin e publikut dhe rritjen e transparencës, e që do të ndikojë në besimin e publikut, ashtu që i njëjti pas koordinimit me prokurorët do të mund të japë informacion të saktë për qytetarët pa prekur pjesën konfidenciale.
- Për të siguruar një punë cilësore është e rëndësishme të hartohen planë që forcojnë kapacitetin, efikasitetin, transparencën dhe integritetin e punës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë. Kjo siç u theksua në bashkëpunim me KPK-në dhe ZKPSH-në do të bëhet duke:
- a) **Rritur numrin e prokurorëve**, duke qenë se është hapi më i rëndësishëm, e që do të ndikojë në trajtimin e rasteve penale;


- b) Rritja e numrit të stafit mbështetës administrativ, që ndikon në rritjen e numrit të rasteve të zgjidhura dhe trajtimin më efikas të çështjeve;
- c) Trajtimi dhe zbatimi i procedurave alternative (ndërmjetësimit, pezullimit të përkohshëm të procedurës dhe marrëveshjes për pranimin e fajësisë);
- d) Aplikimi i programit SMIL për çdo veprim të ndërmarrë, e po ashtu edhe aplikimi i AI (Intelegjenca artificiale) që ndihmon në marrjen e informatave në kohë të shpejtë.

- Në bashkëpunim me Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Këshillim Prokurorial të Kosovës, synoj të krijojmë një program të qartë për etikën dhe integritetin, e duke u bazuar edhe në Kodin e Etikës dhe rregullat që duhet të ndjekin prokurorët dhe stafi mbështetës. Po ashtu, krijimi i një mekanizmi të brendshëm për shqyrtimin e ankesave dhe mbikëqyrjen e rasteve të mundshme të konfliktit të interesit, me qëllim të promovimit të llogaridhënies.

Bashkëpunimi me organizatat që promovojnë transparencën dhe sundimin e ligjit për të përmirësuar besimin e publikut dhe për të mbështetur Prokuorinë në rritjen e efikasitetit.

**Deklaroj se përmbajtjen e këtij konceptdokumenti e kam përgatitur vetë dhe jam në dijeni se i njëjti do të publikohet në uebportal.**

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_



Datë: \_\_\_\_\_

07.11.2024